REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2638/3 Prot. Vlorë më, 01 .10 .2026

VENDIM
Nr.52, datë 01.10.2026

PËR

MIRATIMIN E ELEMENTEVE PËRBËRËSE DHE FORMËS SË DIPLOMËS SË PROGRAMIT PROFESIONAL 2 (DY) VJEÇAR "PROGRAMIM WEB DHE DIZAJNIM DIGJITAL"

Në mbështetje të nenit 38 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të Udhëzimit nr. 10, datë 30.03.2020, "Për përcaktimin e elementeve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurën e regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave ose Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor", të ndryshuar; të nenit 19 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; të nenit 65, pika 1, të Rregullores së Brendshme të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; të Vendimit të Senatit Akademik nr. 105, datë 20.11.2020, "Mbi elementet përbërës dhe formën e diplomës të lëshuar nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë"; të Vendimit të Senatit Akademik nr. 48, datë 29.09.2023, "Për një ndryshim në formatin e diplomës së lëshuar nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë"; si dhe referuar shkresës së Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike me nr. 2610 prot., datë 30.09.2026, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 01.10.2026,


VENDOSI:

1. Të miratojë elementet përbërëse dhe formën e diplomës së Programit Profesional 2 (dy) vjeçar "Programim Web dhe Dizajnim Digjital", sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike.
3. Bashkëlidhur formati i diplomës.
4. Ky vendim sëbashku me formatin e diplomës së miratuar përcillet në QSHA.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Aurela Saliaj

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Ëeb-site: ëëë.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI " ISMAIL QEMALI " VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE

Diplomë

"Diplomë profesionale"

"Programim web dhe dizenjim digjital"

(Nr.krediteve 120 ECTS, Niveli 5 i KSHK)

Foto

Emri Atësi Mbiemri(Mbiemri pas martese)

(Lindur në Qyteti, më 00.00.0000)

Në përfundim të studimeve dhe pas plotësimit të detyrimeve akademike të programit, diplomohet.

Numri unik i identifikimit të diplomës: 000000
Nr. i Matrikullimit: 000000000
ID e Maturës Shtetërore /Nr.i njëvlefshmërisë së diplomës (Nr.i regjistrit) : 000000000

Nr. i Diplomës : 00.00.0000
Lëshuar në Vlorë, më 00.00.0000
Data e përfundimit të studimeve : 00.00.0000
Kohëzgjatja normale e programit të studimit : 3 vjet
Forma e studimeve: Me kohë të plotë

Dekani

Rektori

Virtus - Scientia - Veritas

Shënim: Kjo diplomë shoqërohet nga suplementi i saj